

L. PORADECI – Poradeci

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Poezia ka disa nivele leximi. Në një nga këto nivele përshkruhet ardhja e natës.

Gjeni elementët me të cilat jepet ardhja e kësaj nate.

Çfarë mund të jetë *shkrumb' i natës që po bije*?

Cila është pamja / përfytyrimi që na sugjeron strofa e parë e poezisë?

Këtij përfytyrimi poetik të ardhjes (zbritjes) së natës a mund t'i japim një kuptim të dytë metaforik?

Cila është atmosfera që mbizotëron në strofën e dytë (në dy vargjet e para të saj) dhe me çfarë elementësh e realizon poeti atë?

Si ta shpjegojmë *kërcitjen e një porte në Katund* (që është zhurmë e lëvizje), ndërkohë që Lasgushi kërkon të na përcjellë gjendje qetësie, heshtjeje dhe moslëvizjeje?

-shënime-

Argumentoni që dy vargjet e tjera të kësaj strofe janë rrjedhim logjik i të parave.

Në ç'forma shfaqet largimi, ikja, mërgimi në këto dy vargje?

Pse përmendet pikërisht shqiponja për të ilustruar këtë mërgim, largim?

Si e përforcon leximin e poezisë në këtë këndvështrim nacional dhe etnik Lasgushi?

Ç'kuptojmë me vargjet:

*Tërë fisi, tërë jeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...
Zotëroj më katër anë errësira...*

Në një sërë poezish, pasi përshkruan poetikisht vdekjen ose ardhjen e saj, Lasgushi jep mesazhin se jeta e gjen mënyrën për të mbijetuar.

A mund ta konsiderojmë edhe poezinë “Poradeci” të këtij lloji?

Lasgushit i duhet lumi për të dhënë mesazhin e mbijetesës.

Po pse pikërisht Drini? Gjeni tipare të Drinit për të argumentuar mendimin tuaj.

-shënime-

Përfundimisht a është kjo poezi një lirikë peizazhi?

Kur dhe me çfarë funksioni stilistik përdoret trepikëshi në këtë poezi?

Tregoni veçantinë ritmike të strofës së tretë nga dy të parat.

*Tërë fisi, tërë jeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...
Zotëroj më katër anë errësira...*

Një nga pjesët më karakteristike të fjalorit të Lasgushit janë kompozitat (dhe mënyra karakteristike e shkrimit të tyre).

Gjeni disa të tilla.

Gjeni disa fjalë që Lasgushi nuk i ka marrë nga gjuha standarde letrare, por drejtpërdrejt nga dialekti jugor.

Ç'tipar fiton gjuha poetike nga përdorimi i këtyre fjalëve?